



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry
of Trade and Industry**
Departamenti i Tregtisë/ Departament Trgovine / Department Of Trade

Raport Analitik i Tregtisë në Shërbime – Sektori i TIK

Autor: Mirsad Simnica
Shqipe Jashari

Korrik 2017

Hyrje

Tregtia në shërbime në Kosovë në vitin 2016 ka arritur në total prej 1,498 Miliard Euro. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshinë një shumë prej 1,038 Miliard Euro, ndërsa importi një shumë të përgjithshme prej 460 Milion Euro. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitiv prej 579 Milion Euro. Nëse e krahasojmë me vitin 2015, shohim se eksporti i shërbimeve ishte 887 Milion Euro, përderisa importi rezultoi me 467 Milion Euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve. Duke u bazuar në këto shifra, shohim se ka një trend pozitiv të rritjes së eksportit të shërbimeve me 151 Milion Euro më shumë të hyra apo kalkuluar në përqindje me 17%.

Sektorët kryesorë të cilët kontribuan drejt një bilanci tregtar pozitiv për periudhën (janar – dhjetor 2016) janë: udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 809 Milionë Euro, e ndjekur nga biznesi dhe shërbime profesionale me 63 Milion Euro, shërbimet e informacionit dhe komunikimit (TIK) me 48.5 Milionë Euro shërbimet e ndërtimit me 13 Milion Euro dhe shërbimet qeveritare me 35.5 milionë euro.

Tregtia në Shërbime / Bilanci tregtar në periudhën 2014-2016

Viti	Eksporti i shërbimeve	Importi i shërbimeve	Bilanci
	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>
2016	1038.4 (miliard)	473.4	565
2015	951.5	494.4	457.1
2014	928.6	468.7	459.9

(Burim: Banka Qendrore e Kosovës)

Ky raport analitik ka për synim që të shpjegoj rolin e sektorit të TIK-ut në gjendjen aktuale ekonomike në Kosovë dhe mundësitë e rritjes dhe zgjerimit të saj duke u fokusuar më shumë në vlerën e shtuar të saj.

Eksporti i Shërbimeve / Sektori i TIK

Viti	2014	2015	2016
	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>	<i>milion euro</i>
Shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit	77.7	54.8	48.4

(Burim: Banka Qendrore e Kosovës)

Nga të dhënat për eksportin në tabelën e paraqitur mund të shohim se kemi një trend negativ ku nëse krahasojmë vitin 2016 ku eksporti i shërbimeve të TIK-ut ka qenë 48.4 Milion Euro me vitin 2015 ku eksporti ka qenë 54.8 mund të shihet se kemi një rënie për 6.4 Milion Euro, nga kjo del se për kompanitë e TIK në vendet e synuara, pengesat më të rëndësishme për ndërtimin e kapaciteteve të tyre të eksportit gjatë viteve ishin: mungesa e markës së industrisë informatike vendase jashtë vendit, mungesa e kontakteve të biznesit në tregjet e synuara, si dhe mungesa e informacionit të tregut. Por ka edhe disa pengesa themelore: kërkesat për viza ose barriera kulturore dhe gjuhësore, madje edhe kostot e eksportit dhe stafit me përvojë për të kryer atë lloj aktiviteti. Të gjitha këto janë sfida që ende nuk janë zgjidhur dhe që duhet të ballafaqohen në të ardhmen e afërt, në mënyrë që këto kompani të mund të shfrytëzojnë potencialin e plotë të një prej industrive më fitimprurëse.

Roli dhe politikat e Qeverisë

Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme se sektori i TIK-ut është një komponentë kritike e një vargu të gjerë të aktiviteteve ekonomike kombëtare, jetike për krijimin dhe kultivimin e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, si dhe vendimtare në kohezionin shoqëror dhe në përhapjen e dijes tek të gjitha shtresat e shoqërisë. Andaj, në bashkëpunim dhe asistencë teknike të BE-së ka hartuar një dokumentin “Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020”.

Politikat e sektorit të Komunikimeve Elektronike - Agjenda Digjitale për Kosovën 2013–2020 janë hartuar duke pasur parasysh se zhvillimi i teknologjisë informative është proces dinamik dhe që vazhdimisht pëson ndryshime të shpejta në fusha të shumta të aktiviteteve publike dhe shtetërore, dhe përfshirja e suksesshme e sektorit publik në promovimin e efekteve pozitive dhe minimizimin e atyre negative në këtë proces është kontribut i madh në zhvillimin e qëndrueshëm të Shoqërisë së Informacionit.

Qëllimi i Politikave është që të përkufizohen prioritetet, objektivat dhe detyrat e zhvillimit të TIK-ut për t'i maksimizuar përparësitë sociale dhe ekonomike që i ofrojnë ato teknologji, kryesisht interneti, si instrument shumë i rëndësishëm për aktivitete ekonomike dhe sociale, shfrytëzimi i të cilit mundëson ofrimin apo pranimin e shërbimeve, punëve, qasje në argëtim, komunikim dhe shprehje të lirë të mendimeve. Politikat trajtojnë Shoqërinë e Informacionit si shoqëri të hapur dhe të arsimuar, pjesëtarët e së cilës përdorin TIK-un në mënyrë efektive në të gjitha fushat e aktiviteteve. Objektivi strategjik i politikave është përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e Kosovës si dhe mjedisit afarist për kompanitë përmes shfrytëzimit të mundësive të krijuara nga TIK dhe rritja e përqindjes së përdoruesve të internetit në Kosovë deri në së paku 85 % deri në vitin 2020.

Objektivat kryesore të këtyre politikave janë:

1. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut.
2. Zhvillimi i përmbajtjeve dhe shërbimeve elektronike dhe promovimi i përdorimit të tyre.
3. Avancimi i aftësive të banorëve të Kosovës në përdorimin e TIK.

Objektivi i parë është që të sigurohet zhvillim konsistent në kuptimin gjeografik të rrjeteve të komunikimeve elektronike brezgjera (broadband) në tërë territorin nacional dhe promovimi i përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Objektivi i dytë është që të arrihet siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të rritur besimin e publikut dhe bizneseve në hapësirën kibernetike.


Objektivi i tretë është promovimi i zhvillimit të e-biznesit. Është objektiv që të inkurajohen banorët e Kosovës që t'i përvetësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nevojshme për përdorim të suksesshëm të TIK dhe të përfshihen në Shoqërinë e Informacionit, për të përmirësuar cilësinë e tyre të jetës dhe për të zvogëluar përjashtimin e tyre social (Agjenda Digjitale e Kosovës 2013-2020 MZHE).

Tregtia në shërbime në Shqipëri

Shërbimet në Shqipëri luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe ato përbënin 52.3% të GDP-së në vitin 2015 (OBT, 2016). Eksporti i shërbimeve në vitin 2015 rezultoi me 2 miliardë euro, importi 1.5 miliard euro, ndërsa bilanci 500 milion euro (EU Report, 2016). Sektorët që kontribuan më së shumti ishin: udhëtimi, turizmi, shërbimet e komunikimit dhe shërbimet afariste.

Sektori i TIK-ut është njëri nga sektorët me performancën më të mirë në Shqipëri dhe duke u bazuar në të dhënat e OBT-së në vitin 2015 eksporti shënoj rritje 18% nga 100 milion euro në 118 milion, ndërsa importi ishte 55 milion euro. Tabela nr.2 ilustron ndryshimet ndër vite dhe nën-sektorët e përfshirë.

Tabela nr. 2: Statistikat e sektorit të TIK-së, eksporti dhe importi në Shqipëri



Partner	Value (Mil.US\$)			% in total services - 2016	% in world - 2016	Average growth		
	2014	2015	2016			2005 - 2016	2015	2016
Exports								
Telecommunications services								
World	151.22	100.64	118.32	4.5	100.0	5	-33	18
Audiovisual and related services								
World	2.38	1.47	3.04	0.1	100.0	79	-39	107
Postal and courier services								
World	4.15	1.81	1.96	0.1	100.0	23	-56	8
Imports								
Telecommunications services								
World	53.91	47.77	55.26	3.2	100.0	13	-11	16
Audiovisual and related services								
World	2.39	2.37	2.73	0.2	100.0	13	-1	15
Postal and courier services								
World	1.87	1.21	1.07	0.1	100.0	29	-35	-11

(OBT Statistikat, 2016)


Sa i përket politikave fiskale, Shqipëria qysh nga viti 2002 ka liruar nga detyrimet doganore mallrat dhe shërbimet. Qëllimi i qeverisë ka qenë që të stimuloj më shumë sektorin e TIK-ut në importin e teknologjisë së re dhe inovative me çmime më të volitshme, ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe rritjen e punësimit. Për dallim nga vendet e rajonit që detyrimet doganore variojnë nga produkti i importuar, Shqipëria ka aplikuar një masë të përgjithshme dhe jo-diskriminuese ndaj të gjitha mallrave dhe shërbimeve të këtij sektori. Ndërsa sa i përket TVSH-së shumica e mallrave dhe

shërbimeve që ndërlidhen me sektorin e TIK-ut, me potencial për zhvillimin e këtij sektori aplikohet TVSH-së e zbritshme duke filluar nga më e larta 20% dhe deri te më e vogla që është 8%.

Tregtia në shërbime në Maqedoni

Tregtia në shërbime në Maqedoni në vitin 2016 kur flasim për eksport ishte rreth 1.6 miliard euro, ndërsa importi 1.3 miliard euro. Sektorët me performancë më të mirë ishin: shërbimet e udhëtimit & turizmit, shërbimet afariste, shërbimet e TIK-ut dhe shërbimet e transportit. Sa i përket shërbimeve të TIK vlera e eksportit për vitin 2016 ishte 60 milion euro, dhe krahasuar me vitet paraprake ka shënuar rënie. Tabela nr.3 ilustron ndryshimet ndër vite dhe nen-sektorët e përfomuar.

Tabela nr.3: Statistikat e sektorit TIK, eksporti dhe importi në Maqedoni



Partner	Value (Mil.US\$)			% in total services - 2016	% in world - 2016	Average growth		
	2014	2015	2016			2005 - 2016	2015	2016
Exports								
Telecommunications services								
World	81.83	60.15	59.76	3.7	100.0	3	-27	-1
Audiovisual and related services								
World	7.29	9.67	7.01	0.4	100.0	9	33	-28
Postal and courier services								
World	3.56	2.63	2.80	0.2	100.0	10	-26	6
Imports								
Telecommunications services								
World	43.61	48.98	34.04	3.0	100.0	5	12	-30
Audiovisual and related services								
World	18.40	16.49	12.27	1.1	100.0	13	-10	-26
Postal and courier services								
World	3.50	3.02	3.58	0.3	100.0	29	-14	19

(OBT Statistikat, 2016)


Meqë, sektori i TIK në Maqedoni është konsideruar si shumë i rëndësishëm, në vitin 2007 Qeveria e këtij vendi filloj të aplikoj një politikë “Secili fëmijë duhet të ketë qasje në një pajisje kompjuterike” duke ndryshuar politikat fiskale të vendit. Me eliminimin e tarifave doganore dhe uljen e TVSH-së nga 18% në 5% Maqedonia arriti që brenda një periudhe shumë të shkurt

të jetë një vend atraktiv edhe për vendet e rajonit sa i përket kësaj fushe dhe produkteve/shërbimeve që i ofronin. Si rezultat i kësaj politike Maqedonia shënoj rritje edhe në fushat e tjera si: turizmi, tregtia më pakicë, shërbimet afariste dhe profesionale (TIK STIKK Report, 2011).

Tregtia në Shërbime në Mal të Zi

Edhe Mali i Zi në vitin 2016 sa i përket tregtisë në shërbime në përgjithësi kishte një performancë të mirë dhe me bilanc pozitiv. Eksporti në vitin 2016 ishte rreth 1.4 miliard euro, ndërsa importi 517 milion euro. Nga kjo mund të shihet që Mali i Zi kishte një bilanc pozitiv jashtëzakonisht të lartë rreth 883 milion euro. Sektorët që kishin performancë më të mirë ishin: turizmi & udhëtimi; shërbimet rekreative, kulturore dhe sportive; shërbimet e transportit; dhe shërbimet e TIK-ut. Tabela nr.4 ilustron ndryshimet ndër vite dhe nën-sektorët e performuar.

Tabela nr.4 Statistikat e sektorit të TIK, eksporti dhe importi në Mal të Zi



Partner	Value (Mil.US\$)			% in total services - 2016	% in world - 2016	Average growth		
	2014	2015	2016			2005 - 2016	2015	2016
Exports								
Telecommunications services								
World	41.31	56.95	48.04	3.4	100.0	...	38	-16
Audiovisual and related services								
World	2.12	1.80	2.25	0.2	100.0	...	-15	25
Postal and courier services								
World	0.86	0.72	0.53	0.0	100.0	...	-16	-26
Imports								
Telecommunications services								
World	15.51	18.35	32.52	6.3	100.0	...	18	77
Audiovisual and related services								
World	14.81	13.56	16.23	3.1	100.0	...	-8	20
Postal and courier services								
World	0.88	2.30	1.37	0.3	100.0	...	161	-40

(OBT Statistikat, 2016)

Edhe Mali i Zi ka eliminuar tarifatat doganore me hyrjen në fuqi të MSA-së, gjithashtu ka ndryshuar politikatat fiskale duke aplikuar uljen e TVSH-së nga 19% në 7% në vitin 2013 në të gjitha produktet dhe shërbimet.

Roli i TIK në zhvillimin ekonomik

Roli i TIK-ut është i rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik pasi vepron si një mjet për të përmirësuar produktivitetin dhe për të sjellë një vlerë të shtuar. Karakteristika shtesë e TIK është se ajo përfaqëson një indikator të rëndësishëm për inovacionin dhe aktivitetet e bazuara në njohuri, të cilat, nga ana tjetër, ndikojnë në rritjen ekonomike. Si rezultat i drejtpërdrejtë i nevojave të tanishme ekonomike dhe zhvillimeve të vazhdueshme teknologjike, industria e TIK po kalon një numër sfidash themelore. Në mënyrë që të mbeten të rëndësishme për klientët dhe klientët e tyre, është gjithnjë e më e rëndësishme që bizneset të monitorojnë zhvillimet nga afër, duke përshtatur produktet dhe shërbimet esenciale për të përmbushur kërkesat e reja të tregut. Tregu i TIK-ut në Kosovë, megjithëse më i vogël se ai i vendeve të rajonit, është raportuar të regjistrojë një rritje të vazhdueshme, që është më e lartë se ajo në vendet përreth. Bizneset e TIK-ut presin të rriten më së shumti në nivel lokal, në fusha të tilla si ofrimi i shërbimeve të internetit, zhvillimi / programimi i softuerit, mirëmbajtja dhe riparimi, shitjet e shitësve, shërbimet inxhinierike, trajnimi / certifikimi, shërbimet e informacionit dhe zhvillimi i uebit. Por, për çdo rritje të ndjeshme, duhet të plotësohen disa kushte, më e ngutshme është krijimi i një klime të favorshme biznesi për TIK-un, duke sjellë pagesa tatimore dhe doganore në krahasim me atë të vendeve fqinje dhe krijimin e skemave të tjera nxitëse për TIK. Disa politika fiskale të ndërmarra nga Qeveria mund të sjellin ndikim të madh si për industrinë e TIK-ut në Kosovë, ashtu edhe për bizneset jo-TIK.

Shumica e kompanive të TIK në Kosovë (88%) janë familjare, 2% kanë pronësi me shumicë Kosovare, 3% kanë pronësi të barabartë nga pronarët Kosovarë dhe të huaj, dhe 8% janë kompani me kapital të huaj. Është e rëndësishme të theksohet se ka më shumë kompani të TIK-ut me pronësi të përzier Kosovare dhe të huaj, si dhe kompani me të gjithë pronësinë e huaj. Po ashtu, është vënë në dukje se sektori i TIK-ut është i organizuar mirë, ku mbi gjysma e

kompanive të TIK-ut janë anëtarë të një industrie ose shoqate profesionale, ndërsa 80% e kompanive jo-TIK nuk janë.

Shumica e kompanive të TIK-ut (87%) kanë klientët e tyre në Kosovë, me një numër të vogël biznesesh (13%) që kanë klientë jashtë vendit (nga 3.3% në 2010). Industria kryesore aktualisht e synuar nga shumica e kompanive të TIK-ut në Kosovë është Telekomunikacioni (66%), e ndjekur nga Qeveria, Policia dhe Shërbimet e Urgjencës (46%) dhe Sektori Financiar (45%). Industritë e tjera të synuara janë shërbime me pakicë, me shumicë, profesionale, shkencore dhe teknike, arsim dhe trajnim etj (IT Barometri - STIKK, 2016).

Industria e TIK-ut është e një rëndësie strategjike për zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës për disa arsye:

- Zhvillimi i sektorit të TIK do të kishte ndikim direkt në rritjen ekonomike duke krijuar vende të punës dhe gjenerimin e të ardhurave.
- Duke marrë parasysh strukturën dhe përparësinë konkurruese të industrisë së TIK-ut në Kosovë, vendi ka potencial të ndjekë shembullin e Estonisë dhe Bullgarisë duke përdorur industrinë e TIK-ut si një katalizator për rritjen ekonomike.

Efekti pozitiv i industrisë së TIK-ut në krijimin e vendeve të punës është përforcuar nga fakti se TIK është një industri e fuqisë punëtore intenzive dhe industrisë së aftësive intensive. Në industrinë e TIK (veçanërisht në zhvillimin e softuerit), shkalla është arritur duke kualifikuar dhe punësuar më shumë njerëz. Sa i përket punësimit, zhvillimi i sektorit të TIK ka dy efekte pozitive: një sasi duke rritur numrin e vendeve të punës dhe një cilësor duke krijuar punësim për njerëzit më të kualifikuar. Kështu, sektori i TIK-ut në Kosovë mund të luajë një rol të rëndësishëm në uljen e papunësisë, veçanërisht në mesin e të rinjve.

Duke pasur parasysh se tregtia në shërbime në të gjitha vendet ka një rol kyç në zhvillimin ekonomik, gjithashtu sektori i TIK-ut është në zhvillim i cili do të ketë ndikim direkt në eksport. Rritja e eksporteve është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën, për shkak të bilancit të saj negativ tregtar dhe tregut relativisht të vogël dhe të pazhvilluar të brendshëm. Rritja e eksporteve të TIK-ut do të ofrojë një numër përfitimesh afatgjate për Kosovën, të tilla si përshpejtimi i transformimit në një ekonomi të bazuar në dije nëpërmjet transferimit të teknologjisë dhe krijimit të vendeve më të mira dhe me paga më të larta.

Si teknologji ndër-sektoriale, TIK është një nxitës i inovacionit të produktit dhe procesit. Për më tepër, TIK luan një rol kyç në ekonominë e bazuar në njohuri, ku rëndësia e saj strategjike do të rritet ndjeshëm për shkak të mega-tendencave siç është interneti i gjërave. Prandaj, TIK mund të luajë një rol vendimtar në rritjen e kapacitetit për inovacionin e ekonomisë së Kosovës. Përveç kësaj, sektori i TIK-ut mund të shërbejë gjithashtu si një katalizator për sipërmarrjen dhe krijimin e një start-up vibrant. Një rast i tillë është Qendra Kosovare e Inovacionit (ICK), e cila demonstroi potencialin e industrisë së TIK për sipërmarrjen dhe inovacionin. (Strategjia e Kosovës për IT)

Vendet në zhvillim me industri të forta kombëtare të TIK-së zakonisht bëjnë më mirë tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD). Kështu, promovimi i industrisë të TIK-ut të Kosovës mund të ndihmojë në nxitjen e investitorëve të huaj dhe të tërheqë më shumë IHD, duke përmirësuar imazhin e saj, bazën teknike dhe të aftësive, dhe klimën e biznesit.

Të gjeturat nga vizitat e realizuara te kompanitë vendore dhe barrierat e identifikuara

Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e Shërbimeve me 10 mars 2017, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare me 3 prill 2017. Bazuar në këtë ligj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë konkretisht Departamenti i Tregtisë është interesuar dhe angazhuar që edhe më tej të ndihmojë në zhvillimin e sektorit të shërbimeve duke bërë hulumtime lidhur me kompanitë që ofrojnë shërbime brenda dhe jashtë Kosovës, me fokus në kërkesat e kompanive dhe shoqatave profesionale për fuqizimin e sektorit të shërbimeve dhe reduktimin, eliminimin e barrierave tregtare, ligjore dhe administrative.

Me këtë rast gjatë muajve Shkurt - Prill 2017, janë vizituar Oda, Shoqata si dhe kompani private të ndryshme me qëllim të evidentimit të barrierave eventuale gjatë ofrimit të shërbimeve.

Tema të cilat janë diskutuar në këto takime janë:

1. Informimi lidhur me punën aktuale të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë respektivisht Departamentit të Tregtisë në lidhje me rregullimin dhe lehtësimin e proceduarave për ofrimin e shërbimeve.
2. Informimi mbi Ligjin e Shërbimeve.
3. Informimi për negocimin e shërbimeve me vendet e CEFTA-së.
4. Njohja e dokumenteve dhe kualifikimeve profesionale në vendet e rajonit.

5. Sigurimi i informatave lidhur me llojet e shërbimeve që ofrojnë kompanitë në fjalë , nëse ofrohen shërbimet brenda apo jashtë vendit. Barrierat eventuale me të cilat ballafaqohen gjatë ofrimit të shërbimeve.
6. Çështje të tjera që ndërlidhen me ligjin e ri dhe kërkesat e bizneseve.

Në sektorin e TIK janë vizituar kompanitë: Baruti AG, IQ to Link, 3CIS, Gjirafa dhe Shoqata STIKK dhe çështjet e identifikuara në këtë sektor janë si në vijim:

- Zvogëlimi ose eliminimi i doganës në pajisjet e IT-së
- Promovimi sa më i madh i sektorit të TIK
- Barriera kulturore dhe gjuhësore

Ndërsa, si barriera më të theksuara janë:

- Kërkesat për vize
- Mungesa e emërimit (brendimit) të industrisë informatike vendore jashtë vendit
- Mungesa e mbështetjes nga institucionet qeveritare (skemat e financimit të eksportit, etj)

Të gjeturat nga vizitat e realizuara në Shqipëri dhe Mal të Zi

Me datën 20 dhe 21.06.2017 janë realizuar vizitat hulumtuese për Tregtinë në Shërbime – Sektorin e TIK-ut në Tiranë dhe Podgoricë. Gjatë qëndrimit tonë në këto dy vende kemi realizuar takime me zyrtar të Departamentit të Inovacionit dhe Mirëqeverisjes dhe drejtuesin e shoqatës AITA (Albanian IT Association), Tiranë dhe Zyrtarët e Ministrisë së Administratës Publike, Departamenti i Inovacionit dhe ekspertin e pavarur në fushën e TIK, Podgoricë.

Temat të cilat janë diskutuar:

- Informimi lidhur me punën aktuale të institucionit në lidhje me rregullimin dhe lehtësimin e proceduarave për ofrimin e shërbimeve (politika fiskale, dogana dhe TVSH-ja)
- Prezantimi dhe diskutimi mbi çështjet e sektorit TIK dhe ofrimin e shërbimeve të TIK
- A janë dhe si janë të rregulluara shërbimet e TIK (Dhoma, Asociacione, Shoqata etj.)
- Cilat janë barrierat eventuale me të cilat ballafaqohet sektori i TIK gjatë ofrimit të shërbimeve

- Sektori i TIK - disa të dhëna statistikore për Shqipërinë dhe Malin e Zi dhe rëndësinë e tyre me qëllim të krahasimit me Kosovën
- Njohja e Kualifikimeve Profesionale
- Themelimi i Pikës së Vetme të Kontaktit.

Nga pala Shqiptare jemi informuar se pajisjet teknologjike të cilat importohen në vend janë me tarifë doganore 0, d.m.th janë të liruar nga dogana, ndërsa sa i përket TVSH-së shumica e mallrave dhe shërbimeve që ndërlidhen me sektorin e TIK, me potencial për zhvillimin e këtij sektori aplikohet TVSH-së e zbritshme duke filluar nga më e larta 20% dhe deri te më e vogla që është 8%. Shqipëria, gjithashtu sikurse Kosova ka të rregulluar shërbimet e TIK, dhe ato përfaqësohen nga Shoqata e TIK e Shqipërisë.

Lidhur me barrierat eventuale që ende sektori i TIK-ut ballafaqohet në Shqipëri është përkrahja e vazhdueshme e SME-ve, mungesa e fondeve start-up, financimi në zgjerimin e kapacitete operative etj.

Sa i përket Pikës së Vetme të Kontaktit – Qeveria e Shqipërisë është duke punuar intensivisht në themelimin e portalit E-Qeveria duke shfrytëzuar metodologjinë e PVK, por duke inkorporuar edhe më shumë institucione dhe informata dhe qasjes së tyre në kohë më të shkurtër.

Takimet janë mbyllur me diskutime ku janë ndarë eksperiencat në fushën e shërbimeve dhe temave të cekura më lart, gjithashtu është diskutuar për gjetjen e mundësisë së bashkëpunimit bilateral për sektorin e TIK. Nevoja e bashkëpunimit për zhvillimet e mëtejshme të rajonit përmes:

- Zhvillimin e shërbimeve cross-border (ndërkufitare) dhe ndërveprimin e sistemeve dhe shërbimeve;
- Rritje të kapaciteteve, aftësive dhe promovim të kooperimit të brezit të ri,
- Krijimin e punësimit për brezin ri etj.

Lidhur me takimin në Mal të Zi të gjeturat janë se ky vend nuk disponon ndonjë shoqatë apo odë të TIK-ut. Fatkeqësisht sektori i TIK-ut nuk ishte ende i rregulluar mirë dhe në bashkëbisedim me palën Malazeze ata ishin shumë të interesuar të mësonin më shumë rreth Kosovës dhe sektorit të TIK-ut duke filluar nga rregullimi e deri të statistikave. Politikat fiskale edhe në Mal të Zi ishin më të favorshme sesa në Kosovë. Mali i Zi ka eliminuar tarifën doganore me hyrjen në fuqi të MSA-së, gjithashtu ka ndryshuar politikën fiskale duke aplikuar uljen e TVSH-së nga 19% në 7% në vitin 2013 në të gjitha produktet dhe shërbimet.

Konkluzionet

Përderisa, ekzistojnë shumë sektorë në të cilët të ardhurat tatimore janë të rëndësishme, kur behet fjale për sektorin e TIK-ut detyrimet tatimore luajnë shumë pak rol apo hiç, sidomos në pajisjet për edukim dhe shkollim. Eliminimi i këtyre detyrimeve do të ndikonte në zhvillimin ekonomik të vendit në periudhë afatgjatë pasi që është direkt i ndërlidhur me sistemin më të avancuar të arsimit, pastaj si rezultat i uljes së taksave konsumi do të rritej në vend dhe si rezultat i kësaj do të krijoheshin vende të reja të punës . Në vazhdim si politikë e mirë do të ishte që përmes produkteve dhe shërbimeve të TIK-ut target për shitjen e tyre gjatë sezonës verore dhe dimërore të ishte diaspora kosovare, por edhe turistët e huaj që do të vinin për pushime në Kosovë, si dhe misionet e huaja dhe delegacionet e tyre prezent në vend. Sektori i TIK-ut është i ndërlidhur me shumë sektorë të tjerë që do të gjeneronte të hyra për buxhetin e vendit. Përpilimi i politikave fiskalë të duhura dhe mirë të analizuara sipas disa hulumtimeve të OECD do të rriste GDP-në 2-3% për vendet në zhvillim (ITIF, 2016). Disa nga sektorët që janë të ndërlidhur me TIK-un janë: shërbimet afariste dhe profesionale; shërbimet turistike, shërbimet kulturore, shërbimet financiare dhe të sigurimit; shërbimet e transportit etj. Deri në vitin 2016 më shumë se 120 shtete të botës kanë ulur detyrimet tatimore apo edhe eliminuar me qëllim të stimulimit të sektorit të TIK. Duke u bazuar edhe në të dhënat e siguruara nga vendet e rajonit mund të shohim se edhe vendet si: Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë eliminuar detyrimet doganore dhe kanë ulur TVSH-në. Andaj, bazuar në këto dëshmi ka ardhur koha që edhe Kosova të ndryshoj politikat e saja fiskale në menyre që të përfitoj sa më shumë ky sektor i cili në vazhdimësi ka performance pozitive dhe kontribon në bilancin tregtar të shërbimeve dhe njëherit të jetë më konkurrues me vendet e rajonit.

Bibliografia

Agjenda Digjitale e Kosovës – Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 2013-2020.

Agjencioni i Statistikave të Kosovës, 2017

Banka Qendrore e Kosovës – Bilanci i Pagesave (BOP), 2017

Barometri i IT-së, STIKK 2016.

TIK STIKK Raporti, 2011

Organizata Botërore e Tregtisë – Statistikat e Malit të Zi, 2016.

Organizata Botërore e Tregtisë – Statistikat e Maqedonisë, 2016.

Organizata Botërore e Tregtisë – Statistikat e Shqipërisë, 2016

Strategjia e Kosovës për IT, 2016.

ITIF, 2016